



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 102/2013

Prishtinë, më 23.04.2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI**

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti – kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Sala Berisha – Shala dhe Visar Ymeri.

Pjesëmarrës i ftuar: Dritan Gjonbalaj - drejtor i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil – AAC.

Pjesëmarrës të tjerë: Lendita Kika - Berisha dhe Kushtrim Musa - AAC; Isa Dakaj, Gurakuq Kastrati dhe Igballe Rexhaj – Jashari, MTI; Ukë Gashi - ZPRK; Burim Ejupi dhe Dita Dobranja – INDEP; Miradija Gashi - OJQ “VENERA”; Teuta Gashi – Kosova press- gazetare; Pranvera Musa Kosova sot- gazetare dhe Qëndresa Marsori- praktikante.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 16.04.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2012;
4. Shqyrtimi i Raportit me propozim-amendamente për Projektligjin nr. 04/L-181 për produktet e ndërtimit;
5. Shqyrtimi i Raportit me propozim-amendamente për Projektligjin nr. 04/L-187 për treguesit gjeografikë;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.04.2013

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 16.04.2013 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2012

Kryetari – Tha se ashtu siç është paraparë, në këtë pikë të rendit të ditës, do të shqyrtohet Raporti vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2012. Theksoi se është një raport që për nga ana teknike është punuar mirë dhe gjatë shqyrtimit dhe ekspozesë, do ta shohim përmbajtjen e raportit vjetor më qartësisht. Ne kemi ftuar përfaqësuesin e Autoritetit të Aviacionit Civil - AAC, z. Dritan Gjonbalaj, i cili do të bëjë një prezantim të shkurtër për këtë Raport në Komision, dhe pastaj do të hapim debat në lidhje me këtë çështje.

Dritan Gjonbalaj (Autoriteti i Aviacionit Civil - AAC) – Ai fillimisht i njoftoi anëtarët e Komisionit për misionin dhe vizionin e AAC-së. Me këtë rast, Gjonbalaj theksoi se AAC-ja i ka vënë vetes mision që të mbajë sa më lart nivelin e standardeve të sigurisë në Kosovë në fushën e aviacionit civil, duke pasur vizion që të ofrojë sistemin më të mirë të mundshëm të aviacionit civil. Tha se misioni ynë është që të krijojmë një ambient të aviacionit në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, përmes monitorimit të vazhdueshëm, partneritetit me industrinë, si dhe nivelin më të lartë të kompetencës profesionale të personelit. Theksoi se institucionet publike me përgjegjësi në aviacion civil janë: Ministria e Infrastrukturës, Ministra e Punëve të Brendshme dhe Autoriteti i Aviacionit Civil, i raportojnë Kuvendit në lidhje me zbatimin e Ligjit dhe politikave të aviacionit civil dhe për aktivitetin rregullator. Funksioni bazë i AAC-së është mbikëqyrja dhe rregullimi i aktiviteteve të aviacionit civil në Republikën e Kosovës, me qëllim të garantimit të operimeve të sigurta, në përputhje me standardet në fuqi. Kjo arrihet përmes inspektimit, auditimit, licencimit, certifikimit dhe inspektimeve të avionëve të huaj. Pastaj, theksoi se janë në platformë 127 raporte të pranuar nga operatorët (raporti i publikuar) miratimi i transportit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit (miratimet për bartje të mallrave të rrezikshme). Gjithashtu, ai i njoftoi Anëtarët e Komisionit edhe për sistemin e menaxhimit të cilësisë që ofron AAC-ja, mundësitë e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në ICAO, për përshkrimin e hapësirës ajrore të Kosovës dhe aktivitete të tjera të këtij Autoriteti. Sa i përket sistemit të sigurisë, Gjonbalaj nënvizoi se gjatë vitit 2012, AAC-ja ka përfunduar të gjitha veprimet e nevojshme për ngritjen e sistemit për menaxhim të cilësisë, sipas Standardit Ndërkombëtar ISO 9001/2008. Pasi që sqaroi procedurat e anëtarësimit në ICAO, ai në vijim njoftoi edhe për hapat që kanë marrë për anëtarësimin e Kosovës në këta mekanizma të aviacionit ndërkombëtar. AAC-ja, në koordinim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme, ka filluar hulumtimet dhe kontaktet në nivel teknik, për të përgatitur terrenin për dorëzim të aplikimit zyrtar nga institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës për anëtarësim në ICAO. Duke dhënë sqarime për hapësirën ajrore të Kosovës, Gjonbalaj tha se ajo, që nga shtatori i vitit 1999, është pjesë e Hapësirës së Përbashkët Operacionale të Ballkanit -JOA të NATO-s, nën kontrollin operacional të Qendrës së Kontrollit të Operimeve të Kombinuara Ajrore. Kjo hapësirë ajrore është hapësirë e kontrolluar, në të cilën ofrohen shërbime për trafikun ajror, sqaroi ai. Po ashtu, Gjonbalaj njoftoi se hapësira e lartë ajrore e Kosovës, është e mbyllur për trafik komercial dhe për zëvendësimin e kodit RS-Serbia në biletat elektronike të aeroplanëve të udhëtareve me kodin “Republic of Kosovo XK”.

Kryetari – Ngriti disa çështje në lidhje me raportin e auditimit se pse iu është refuzuar licenca disa agjencive ajrore dhe kompanive për furnizime. Më pas ai pyeti: Cili është bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet tjera përkatëse që e rregullojnë fushën e aviacionit civil dhe aktivitetet në rrafshin ndërkombëtar?

Myzejene Selmani – Tha se duke marrë parasysh kompetencat që i ka Autoriteti i Aviacionit Civil në bazë të ligjit, raporti i cili është prezantuar parasheh gjithë efektin e punës së AAC- së. Bëri pyetje për Aeroportin e Gjakovës: Kur do të kalojnë kompetencat nga KFOR- i në Qeverinë e Republikës së Kosovës për ta menaxhuar këtë aeroport? Çështje tjetër që është në raport, është edhe rregullimi në aspektin kontrollimit të hapësirës. Te Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” pyeti në lidhje me punën e kontratës me koncesion.

Teuta Sahatqija – Tha se është një raport i hartuar mirë teknikisht. Pyeti për çështjen Aeroportit të Gjakovës dhe për çështje të tjera: Pse nuk është përmendur në raportin vjetor të AAC- së? Taksa e sigurisë, a është duke u përdorur për sigurinë e udhëtarëve?

Për çmimin e biletave nga Kosova që është shumë i lartë, tha se cilat janë arsyet për moszbritjen e çmimeve të biletave? Po ashtu, kërkoi të dijë pse është larguar nga Kosova “British Airways”.

Hashim Deshishku – Pyeti në lidhje me raportimin në faqen 36 për rregullimin ekonomik, si qëndron rregullimi i operatorëve, ndërsa në faqen 43, te pasqyrat financiare, tha se pse nuk i keni ndarë pagat nga mëditjet, kur dihet se janë çështje të ndara.

Shaip Muja – Parashitroi disa pyetje, si: Cilat janë mallrat e rrezikshme që transportohen në hapësirën ajrore? Mbikalimet në hapësirën e lartë, sa janë përfitimet që kalon nëpër hapësirën e Kosovës? Për aeroportet bujqësore dhe sportive që i ka Kosova, a ka ndonjë plan nga AAC- ja për të ardhmen se çka do të bëhet me këto aeroporte? Me aeroportin e Kukësit, cili është bashkëpunimi i Kosovës apo ANP “Adem Jashari”?

Lutfi Zharku – Pyeti lidhur me mospërdorimin e gjuhës zyrtare në njoftimin që duhet t’u bëhet udhëtarëve në aeroplan nga ana e agjencive dhe pse nuk po e bëjnë këtë. Meqenëse është paraparë edhe me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve dhe Ligjin për AAC-në, duke marrë parasysh se kjo është çështje e sigurisë së udhëtarit, sepse duhet të jetë i njoftuar në gjuhën e tij gjatë fluturimit.

Biserka Kostiq – Tha se kjo çështje duhet të rregullohet dhe njoftimi të jepet edhe gjuhën serbe, sepse është gjuhë zyrtare.

Kryetari – Pyeti edhe në lidhje me atë se a e njoftojnë kompanitë aeroportin para aterimit se kush janë udhëtarët që do të aterojnë me një aeroplan të caktuar, pra a ofrojnë listë të udhëtarëve.

Dritan Gjonbalaj (Autoriteti i Aviacionit Civil- AAC) – U përgjigj në pyetje të deputetëve, si vijon: sqaroi pse iu është refuzuar licenca disa agjencive ajrore dhe kompanive për furnizime dhe tha se kjo ka ndodhur për arsye të moskompletimit të dokumentacioneve; për bashkëpunimin me institucionet tjera të shtetit, përgjegjëse për aviacion, tha se AAC-ja ka marrë pjesë edhe në negociimin e marrëveshjes dypalëshe të transportit ajror me Emiratet e Bashkuara Arabe, si dhe ka përgatitur një koncept dokument për anëtarësim në ICAO; aktivitetet në rrafshin ndërkombëtar janë në bashkëpunim shumë të mirë me Shqipërinë dhe Maqedoninë në fushën e inspektimeve dhe auditimeve të aviacionit civil. Theksoi se kemi bashkëpunim me Francën (është nënshkruar një memorandum i bashkëpunimit teknik), ndërsa sa i përket Aeroportit të Gjakovës, ai sqaroi se atë e ka ndërtuar Qeveria italiane, por në fund të këtij viti ky aeroport do t’i kthehet Qeverisë së Kosovës. Duke folur për numrin e udhëtarëve, ai tha se numri i atyre që

kanë realizuar fluturime nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari", është në rritje të vazhdueshme. Me këtë rast, ai njoftoi se gjatë vitit të kaluar nga ANP-ja, kanë realizuar udhëtime më se 1.5 milion udhëtarë. Për pasqyrat financiare për paga dhe mëditje pse nuk janë ndarë, tha se Ligji për menaxhimin e financave publike e ka të rregulluar në një kod buxhetor ku parashihen pagat dhe mëditjet. Për mallrat e rrezikshme që transportohen në hapësirën ajrore, tha se janë kryesisht armët dhe municioni, ndërsa për mbikalimet në hapësirën e lartë që kalon nëpër hapësirën e Kosovës, tha se përftimet nuk mund të jenë të mëdha, pasi që territori i Kosovës është i vogël. Sa u përket aeroporteve bujqësore dhe sportive që i ka Kosova, ai tha se këto aeroporte kanë një infrastrukturë shumë të dobët dhe janë nën menaxhimin e ndërmarrjeve publike dhe komunave. Për Aeroportin e Kukësit, tha se nuk kanë ndonjë bashkëpunim, për arsyeje se as Shqipëria nuk e përdor për nevoja komerciale. Për mosnjoftimin e udhëtarëve në gjuhët zyrtare të Kosovës gjatë udhëtimeve në aeroplan, tha se është e çuditshme, por tha se kjo mund të ndodhë vetëm te ato kompani të cilat nuk kanë vijë të rregullt me ANP-në, ndërsa për listën e udhëtarëve që aterojnë në ANP, tha se ne tani jemi në konsultime me MPB-në dhe tani kemi një ligj të ri, i cili hyn në fuqi dhe kjo do të mundësohet në të ardhmen. Gjithashtu, ai i njoftoi deputetët se "British Airways" është larguar nga Kosova për shkaqe komerciale, e jo për ndonjë shkak tjetër.

Kryetari – Në fund të diskutimeve që bënë dhe përgjigjeve që morën lidhur me interesimin e tyre, raportin e vlerësoi pozitivisht. Ai, po ashtu, inkurajoi drejtorin Gjonbalaj dhe stafin e tij që të vazhdojnë me këmbëngulësi për të tejkaluar sfidat që paraqiten, duke i ofruar mbështetje edhe nga Komisioni.

Pas debatit të gjerë, Komisioni nxori unanimisht këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil i Kosovës për vitin 2012.

Kuvendit ia paraqiti këtë

Rekomandim

- 1. Të miratohet Raporti vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2012.*
- 2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet kryetari i Komisionit, Zenun Pajaziti.*

4. Shqyrtimi i Raportit me propozim-amendamente për Projektligjin nr. 04/L-181 për produktet e ndërtimit

Kryetari – Tha se grupi i punës e ka shqyrtuar Projektligjin për produktet e ndërtimit dhe ka hartuar disa amendamente, por në mbledhjen e kaluar ka mbetur që grupi i punës, bashkë me përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, të rishikojnë edhe një herë nenin 10 të Projektligjit në fjalë. Theksoi se kryesues i grupit të punës është z.Hashim Deshishku, pastaj fjalën ia dha për t'i prezantuar amendamentet.

Hashim Deshishku – Sa i përket përdorimit të shenjës CE, grupi i punës e ka rishikuar edhe një herë **nenin 10**, me përfaqësuesit Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe është pajtuar që të hartohet **amendamenti 12** në titullin e nenit 10, fjala "shenjës CE" të zëvendësohet me fjalët "shenjës së konformitetit" dhe ky ndryshim të bëhet edhe në nenet tjera që reflekton ky ndryshim. Theksoi se kjo dilemë është rregulluar, pasi që në mbledhjen e kaluar kemi shqyrtuar amendamente tjera. Kërkoj që të miratohen në tërësi, propozim-amendamentet e Projektligjit për produktet e ndërtimit.

Pastaj, Komisioni nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me amendamente i Projektligji nr. 04/L-181 për produktet e ndërtimit.
2. Raporti t'u procedohet komisioneve të përhershme, sipas procedurës.

5. Shqyrtimi i Raportit me propozim-amendamente për Projektligjin nr. 04/L-187 për treguesit gjeografikë

Kryetari – Theksoi se grupi i punës e ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-187 për treguesit gjeografikë dhe ka hartuar disa amendamente, të cilat ne si Komision, do t'i shqyrtojmë sot. Theksoi se kryesues i grupit të punës është z.Hashim Deshishku, të cilit ia dha fjalën për të prezantuar amendamentet.

Hashim Deshishku – Theksoi se grupi i punës ka mbajtur dy takime dhe ka shqyrtuar projektligjin. Në këtë takim kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësuesit Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si sponsorues të projektligjit dhe për të arsyetuar projektligjin në fjalë, si dhe përfaqësues nga organizata INDEP, që po e mbështesin punën e Komisionit. Theksoi se grupi i punës, gjatë shqyrtimit i ka hartuar 42 amendamente. Bëri prezantimin e amendamenteve një nga një.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

1. Miratohen Raporti me amendamente të Projektligjit nr. 04/L-187 për treguesit gjeografikë.
2. Raporti t'u procedohet Komisioneve të përhershme sipas procedurës.

**6. Të ndryshme
Çështjet vijuese**

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit